

QËLLIMET E ARRITJES NË KLASË: STRATEGJITË E TË NXËNIT DHE
PROCESET E MOTIVIMIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIMI

NGA

MARIGONA PECOLLAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË, PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE
KËSHILLIM
PRISHTINË

SHTATOR, 2021

Qëllimet e arritjes në klasë: Strategjitë e të nxënit të studentëve dhe proceset e motivimit

Kandidatja: Marigona Pecollaj

Mentorja: Prof. Ass.Dr. Liridona Jemini- Gashi

Qëllimi i studimit tim është për të parë nëse ndikojnë strategjitë e përdorura dhe proceset e motivimit nga nxënësit në të nxënë në ngritjen e performancës akademike. Pra, për të parë se si motivimi i të mësuarit është i lidhur ngushtë me besimin e të mësuarit, dhe me strategjitë e të mësuarit.

Kapitulli I

Hyrje

Suksesi në arsim, i shtynë studentët jo vetëm të disponojnë aftësitë njohëse të nevojshme, ata gjithashtu duhet të kenë dëshirë ose motivim për të mësuar (Matos, Lens, & Vansteenkiste, 2007). Edukimi ka një rëndësi të jashtëzakonshme, më shumë se kurrë më parë në histori. Për të pasur sukses në arsim, studentët jo vetëm që duhet të disponojnë aftësitë njohëse të nevojshme, ata gjithashtu duhet të kenë dëshirë ose motivim për të mësuar. Kjo është arsyeja pse mësuesit, psikologët arsimorë dhe studiuesit njohën dobën e identifikimit të shtigjeve efektive për të promovuar motivimin adaptues të nxënësve dhe qëllimet e arritjeve në klasa. Rëndësia për studentët për zhvillimin e mënyrave të të menduarit dhe strategjive që mund t'i ndihmojnë ata të përpunojnë informacione, të planifikojnë aktivitete studimore, të monitorojnë vëmendjen e tyre dhe të mbajnë një motiv për të mësuar.

Shqyrtim i literatures-perspektiva teorike

Orientimi i qëllimit është konceptuar si mënyra të ndryshme që një individ mund të adoptojë në ndjekjen e qëllimeve dhe kompetencave në situata të arritjeve. Është një orientim motivues i cili mund të ndikojë në sjelljen e tyre mësimore me kalimin e kohës. Besohet se këto synime do të nxisin modelet e tyre të përgjigjes ndaj detyrave specifike dhe kanë përdorur një kornizë trichotomous në studimin e tyre, ku ata e ndajnë orientimin e qëllimit në tre dimensione të ndryshme, përkatësisht mjeshtëri, performanca dhe orientimi i synimit. Sa i përket kontekstit

kosovar, motivimi, si proces përveç pikave të cekura më parë, mund të stimulohet edhe nga mësuesit, dhe nxënësit arrijnë rezultate të kënaqshme dhe të realizueshme në qëllimet për arritje. Nga studimi që kreu vuri re se motivimi është faktor i rëndësishëm i jetës shkollore dhe pjesë e secilit nxënës. Detyra e mësuesit është të inkuadrojë e të ruajë individualitetin e nxënësit. Faktor tjetër i rëndësishëm për motivimin është edhe mësuesi, sjellja e tij në klasë por jo vetëm, sepse figura e mësuesit për nxënësit ka rëndësi të madhe. Faktor tjetër janë metodat, teknikat dhe strategjitë që i përdor mësuesi për të stimuluar nxënësit. Mjedisi fizik poashtu ka rëndësi në motivimin e nxënësve sepse ju krijon kënaqësi dhe dëshirë për të kaluar një pjesë të konsiderueshme të ditës në shkollë.

Korniza teorike

Motivimi i brendshëm dhe arritja akademike konsiderohen pasoja pozitive dhe negative në qëllimet e arritjes, në varësi të karakteristikave të tyre. Një kornizë teorike 2×2 nga një perspektivë njohëse sociale u shpjegua nga Elliot dhe Murayama. Një model që përfshinte përvojën aktive të të mësuarit dhe si pasojë motivimin e brendshëm dhe arritjen akademike të qëllimeve të arritjes. Dy procedura të modelimit të ekuacioneve strukturore dhanë prova që treguan efektet parashikuese të përvojës mësimore aktive dhe qëllimet e zotërimit në motivimin e brendshëm. Në arritjet akademike u ndikua motivimi i brendshëm, qëllimet e qasjes ndaj performancës dhe përvoja aktive e të mësuarit. Përvoja aktive e të mësuarit shërbeu gjithashtu si një antecedent i katër llojeve të qëllimeve të arritjes.

Pyetjet hulumtuese të këtij studimi janë:

1. A ndikojnë strategjitë e të mësuarit në rritjen e performancës akademike të nxënësve?
2. A ndikon motivimi i nxënësve në rritjen e performancës akademike?
3. Cila është ndërlidhja në mes të strategjive të të mësuarit, performancës akademike dhe motivimit për ngritje akademike?

Hipotezat tregojnë se:

1. Strategjitë e të mësuarit të nxënësve ndikojnë në rritjen e performancës akademike të

nxënësve.

2. Motivimi poashtu ndikon në ngritjen e përfomances akademike.
3. Ekziston një ndërlidhje pozitive në mes të strategjive të të mësuarit, përfomances akademike dhe motivimit për ngritje akademike.

Kapitulli II

Metodologjia

Mostër e këtij studimi ishin 320 nxënës të shkollave të mesme të ulëta, në fshatin Zym, Gjonaj dhe Krajk të rajonit të Hasit, komuna e Prizrenit (arsyeja e përzgjedhjes së tri shkollave të ndryshme ka të bëjë me numrin e vogël të nxënësve). Përzgjedhja e tyre është bërë përmes metodës probabilitare, rastësore. Studimi ishte kuantitativ dhe të dhënat janë analizuar me Paketën Statistikore për Shkenca Sociale-SPSS. Pjesëmarrësit e përfshirë ishin nga klasa e gjashtë deri në të nëntën të të dy gjinive të cilët janë zgjedhur rastësisht në secilën klasë.

Sa i përket matjeve janë përdorur tre pyetësor, duke përfshirë edhe të dhënat demografike. Pyetësi për strategjitë e të mësuarit, proceset e motivimit dhe përfomancën akademike. (Pyetësi i strategjive të të nxënit; McConnell, 2020; Pyetësi i Vlerësimit të Aftësive të Studimit (Houston University; Pyetësi për përfomancën akademike).

Kapitulli III

Rezultatet

Rezultatet kanë të bëjnë me identifikimin që në bazë të analizës regresionale (Adj. $R^2=.029$, $p=.001^b$) strategjitë e të mësuarit dhe proceset e motivimit (Adj. $R^2=.174$, $p=<.001^b$), janë ndër shkaqet kryesore të ngritjes së përfomancës akademike. Sa i përket ndërlidhjes në mes të variablave, rezultatet korrelacionale treguan që, përfomanca akademike ka korrelacion negativ me strategjitë e të mësuarit ($r=-.178$, $p=0.001$), dhe korrelacion pozitiv me proceset motivuese ($r=.420$, $p=0.001$). Ndërsa, proceset e motivimit kanë shfaqur ndërlidhje signifikante pozitive me strategjitë e të mësuarit ($r=.267$, $p=0.001$).

Diskutim

Në këtë studim, përqendrimi kryesor ndaj nxënësve është për të parë se si motivimi i të mësuarit është i lidhur ngushtë me besimin e të mësuarit, dhe me strategjitë e të mësuarit. Duke u bazuar në hulumtimet e mëparshme, tek secili nxënës është vërejtur ndërlidhje në mes të strategjive dhe motivimit, në mënyrë që të ngrisin performancën akademike.

Implikime dhe rekomandime

Bazuar në studime të shumta (Ong, 2014), studimi mund të shërbejë si një udhëzues për programin mësimor të institucionit të arsimit të lartë, që përfshin një qasje të thellë të të mësuarit drejt krijimit të një ekonomie të bazuar në dije. Mundësia që studentët të përqëndrohen në përpjekje, i lejon ata të përdorin strategji të përshtatshme, zgjedhje që janë sfiduese dhe tërheqëse si dhe zhvillim i një orientimi pozitiv drejt të mësuarit. Kontributi për synimin e cilësisë së arsimit vjen gjithmonë si gatishmëri dhe motivim nga ana e mësimeve për avancim të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve. Nxitja e mësimeve për ulje të vëmendjes në krahasimin shoqëror, nuk garanton kufizim të performancës për orientim të mëtutjeshëm.

Bazuar në rezultatet e studimit tonë, rekomandohet ndihmë nga secili individ që nxënësi ndihet mirë pasiqë, pa ndihmën motivuese të jashtme si nga ana e mësimeve, bashkëmoshatarëve si dhe prindërve që janë fuqizim i performancës akademike dhe dëshirës për arritje, nuk mund të themi se fëmijët mund t'ia dalin mbanë vetëm. Pra duke i përfshirë të gjithë, me mund dhe punë të pandalshme do të jemi të aftë të arrijmë t'i plotësojmë ëndrrat dhe dëshirat që i kemi për një të ardhme sa më të ndritur. Nxënësit duhet të besojnë se ata kanë nevojë për motivim dhe strategji të ndryshme mësimore për t'i ndihmuar vetëvetës në ngritje të performancës.